



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Belediyesi



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren

PJESA B: KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA

KK Prizren (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"Ofruesi i Shërbimeve" **OE Infra-Plus SH.P.K., Rr.Prishtinë-Ferizaj KM 5** ne anën tjetër,
janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Hartimi i projektit detal për burimet e ujit të pijshëm nga burimi Vërmicës dhe Poslisht

me numër identifikues: Nr. pro. 622-25-2419-213

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:
[shëno përshkrimin e përgjithshëm të shërbimeve], përshkrimi i përgjithshëm i shërbimeve, është
dhenë në specifikacion që është aneks i kontratës

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë : Vlera totale indikative e kontratës është **23,759.10 €** (njëzet e tre mijë e shtatëdhjetë e nëntë euro e dhjetë cent është çmimi i peshuar për njësimet të cilin është bërë vlerësimi i ofertave)

Kontrata do të lidhe dhe do të realizohet sipas çmimeve për njësi të ofruara nga OE dhe totali i këtyre çmimeve për njësi është **196,785.00 €** (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e pesë euro është çmimi për njësi)

Vlera e parashikuar e kontratës për 180 ditë pune është 200,000.00 € (dyqind mijë euro).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


¹ Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **[angleze][shqipe][serbe]**² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për

Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	29.09.2025
Vula:	

[Ne rast të kontratave me vlerë të madhe]

Emri:	Z. Shaqir Totaj Kryetar
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	30.09.25
Vula:	

Për operatorin ekonomik

Emri:	Arbër Islamaj
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	02.10.2025
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 **"Ofruesi i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.
- 4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.
- 4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

- 5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.
- 5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

- 6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.
- 6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.
- 6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.
- 6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i percaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënua për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratë e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbysur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikën më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojë personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbisht të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguajë dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkalojë shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdojë të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktojë Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofrojë dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bëhet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguajë këtë shumë, dhe do pasojë një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes së kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhën Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/ Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Emri i Autoritetit Kontraktues	1.1	KK Prizren
Emri i Ofruesit të Shërbimeve	1.2	"Ofruesi i Shërbimeve" OE Infra-Plus SH.P.K., Rr.Prishtinë-Ferizaj KM 5
Titulli i kontratës dhe Numri i prokurimit	1.3	Hartimi i projektit detal për burimet e ujit të pijshëm nga burimi Vërmicës dhe Poslisht me numër identifikues: Nr. pro. 622-25-2419-213
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. Gjuha e përdorur do të jetë ;gjuha shqipe
Siguria e ekzekutimit	9.1	10 % e vlerës së kontratës për një periudhë prej 8 muaj kalendarik
Sigurimi	10.1	
Programi i ekzekutimit	11	Plani dinamik për realizimin e projektit do të jetë 180 ditë sipas planit dinamik të ofruar nga ana e OE nënshrkues i kontratës dhe i cili është pjesë e kësaj kontrate
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Të gjitha obligimet tatimore dhe doganoare i bartë Operatori ekonomik.
Patentat dhe licencat	13.1	Sipas specifikacionit të tenderit
Cilësia e shërbimit	18.2	Sipas kërkesës në specifikacion (paramas)
Pagesa	20.1	Pagesat do të bëhen në kiste
Çmimi	21.3	Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë : Vlera totale indikative e kontratës është 23,759.10 € (njëzet e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nënt euro e dhjetë cent është çmimi i peshuar për njësi të cilin është bërë vlerësimi i ofertave) Kontrata do të lidhe dhe do të realizohet sipas çmimeve për njësi të ofruara nga OE dhe totali i këtyre çmimeve për njësi është 196,785,00 € (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pes euro është çmim për njësi) Vlera e parashikuar e kontratës për 180 ditë pune është 200,000.00 € (dyqind mijë euro).
Ndryshim të çmimit	24.1	Nuk do të ketë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	25.1	kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Do të bëhet ndërmjet drejtorit të projektit dhe operatorit ekonomik
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. Gjuha e përdorur do të jetë ;gjuha shqipe
Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të projekti	32.2	Qelë Lamaj Drejtor në DSHP

Menaxher i projektit	33	Ejup Kryeziu IDN në DSHP
Personi pergjegjes per pranimin e sherbimit-organi mbikqyrës	34	Organi mbikqyrës

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Projekti i Zgjerimit të Kapaciteteve të Furnizimit me Ujë të Pijshëm për Qytetin e Prizrenit nga Burimi Vërmica

Përshkrimi i Punimeve

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Totali i çmimit për njësi me TVSH	Peshimi i pikëve %	Çmimi i peshuar
1	Inçizimi gjeodezik dhe topografik si dhe hulumtimet gjeomekanike të lokacionit për hartimin e projekteve të detajuara për objektet hidroteknike, duke përfshirë kaptazhën, stacionin e pompave, rezervuarët.	Copë	1	45,200 €	45,200 €	20.0%	9,040.00 €
2	Hartimi i projektit kryesor për furnizimin dhe instalimin e pajisjeve për furnizimin me energji elektrike.	Copë	1	5,455 €	5,455 €	3.0%	163.65 €
3	Hartimi i projektit kryesor për Ndërtimin e kaptazhës në afërsi të burimit të Vërmicës për kapjen e një sasive uji të lejuar institucionet perketese.	Copë	1	5,455 €	5,455 €	4.0%	218.20 €
4	Hartimi i projektit kryesor për Ndërtimin e rezervuarit grumbullues.	Copë	1	5,455 €	5,455 €	4.0%	218.20 €
5	Hartimi i projektit kryesor për Ndërtimin e rezervuarit kryesor grumbullues, me pajisjet të gjitha pjesët përcjellëse.	Copë	1	20,950 €	20,950 €	15.0%	3,142.50 €
6	Hartimi i projektit kryesor për Ndërtimin e objektit të stacionit të pompave dhe instalimi i setit të pompave, përfshirë instalimet elektrike dhe mekanike.	Copë	1	13,895 €	13,895 €	5.0%	694.75 €
7	Hartimi i projektit kryesor për furnizimin dhe instalimin e gypave transportues për lidhje të kaptazhës dhe rezervuarit grumbullues.	Copë	1	1,850 €	1,850 €	1.0%	18.50 €
8	Hartimi i projektit kryesor për furnizimin dhe instalimin e gypave transportues për lidhje të rezervuarit grumbullues me rezervuarin kryesor; përfshirë pusetat e nevojshme përgjatë segmentit të gypit.	Copë	1	22,095 €	22,095 €	15.0%	3,314.25 €
9	Hartimi i projektit kryesor për furnizimin dhe instalimin e gypave transportues për lidhje të rezervuarit kryesor me rrjetin shpërndarës, përfshirë pusetat e nevojshme përgjatë segmentit të gypit.	Copë	1	21,095 €	21,095 €	13.0%	2,742.35 €
10	Hartimi i projektit kryesor për furnizimin dhe instalimin e gypave transportues për lidhje të rezervuarit kryesor me rrjetin shpërndarës ekzistues të sistemit të ujësjellësit të Prizrenit, përfshirë pusetat e nevojshme përgjatë segmentit të gypit.	Copë	1	14,540 €	14,540 €	8.0%	1,163.20 €
11	Hartimi i projektit kryesor për ndërtimin e objektit dhe për furnizimin dhe instalimin e pajisjeve për dozim dhe dezinfektim.	Copë	1	12,950 €	12,950 €	2.0%	259.00 €
12	Përgatitja e konceptit dhe elaboratit për funksionimin automatik të objekteve dhe pajisjeve përmes sistemit SCADA.	Copë	1	27,845 €	27,845 €	10.0%	2,784.50 €
Totali i Përgjithshëm					196,785.00 €	100%	23,759.10 €



PART B: FORMULARI I KONKURSIT TË PROJEKTIMIT

PJESA I. FORMULARI I KONKURSIT TË PROJEKTIMIT

Për: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

(këtu e tutje "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i konkursit të projektimit: **Hartimi i projektit detal për burimet e ujit të pijshëm nga burimi Vermicës dhe Poslisht**

Zonja/Zotërinjë:

Në përgjigje të ftesës tuaj me shkrim për tenderim për konkursin projektues të cekur më lartë, ne, të nënshkruarit, deklarojmë që:

1. Ne kemi ekzaminuar dhe pranojmë plotësisht përmbajtjen e dosjes së konkursit të projektimit Nr. 622-25-2419-2-1-3. Ne këtu e tutje pranojmë dispozitat në tërësi, par rezerva apo kufizime.

E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	INFRA PLUS SH.P.K
ADRESA E PLOTE	Rr. Prishtine – Ferizaj Km 5, Llapllasellë - Graçanicë
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI DHE MBIEMRI	ARBER ISLAMAJ
POZITA	PROKURIM
NËNSHKRIMI	
DATA	06.05.2025
VULA	



[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

	Emri (emrat)	Vend-selia
Partneri 1*		
Etj ... *		

* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [shëno emrin dhe mbiemrin]

Nënshkrimi: [nënshkrimi i personit të autorizuar]

Vendi dhe data: [shëno vendin dhe datën] Vula e Udhëheqësit: _____

Ne rast te Grupit te OE emri i liderit te Grupit te OE

PJESA III. OFERTA FINANCIARE¹

Për: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i konkursit të projektimit: **Hartimi i projektit detal për burimet e ujit të pijshëm nga burimi Vërmicës dhe Poslisht**

Zonja/Zotërinjë

1. Ne, të nënshkruarit, ofrojmë që të dorëzojmë projektimin e detajuar inxhinierik për konkursin e projektimit të lartë cekur në pajtim me Dosjen e juaj të Konkursit të Projektimit Nr. **622-25-2419-2-1-3** dhe Koncept Propozimin.

2. Propozimi jonë Financiar për projektimin e radhës (projektimin e detajuar inxhinierik) është në shumë prej: Çmimi total i tenderit është:

[23,759.10 - Njëzet e tremijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë euro e dhjetë cent]

3. [Nëse koncept projekti jonë fiton për fazën e radhës së projektimit, ne marrim përsipër të bëjmë nënshkrim të kontratës dhe të dorëzojmë "projektimin e detajuar inxhinierik" brenda [180 ditëve] pas nënshkrimit të kontratës.

4. Operatori Ekonomik kanë këtë nacionalitet: **KOSOVAR**

5. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formë tjetër.

[Në rast të konsorciumit]

[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].


6. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	INFRA PLUS SH.P.K
ADRESA E PLOTE	Rr. Prishtine – Ferizaj Km 5, Llapllasellë - Graçanicë
PËRFAQËSUAR NGA:	

¹ Aplikohet vetëm në rast të kontratës për shërbime pas konkursit që do ti jepet fituesit apo njërit nga fituesit e konkursit



EMRI	ARBER ISLAMAJ
POZITA	PROKURIM
NËNSHKRIMI	
DATA	06.05.2025
VULA	

[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

	Emri (emrat)	Vend-selia
Partneri 1 *		
Etj ... *		

* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [shëno emrin dhe mbiemrin]

Nënshkrimi: [nënshkrimi i personit të autorizuar]

Vendi dhe data: [shëno vendin dhe datën]

Vula e Udhëheqësit: _____

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME

[Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, kërkesat teknike dhe/ose estetike të konkursit të projektimit.]

Specifikimet teknike dhe/ose estetike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e konkursit të projektimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

TERMAT E REFERENCËS

Projekti: Zgjerimi i Kapaciteteve të Furnizimit me Ujë të Pijshëm për Qytetin e Prizrenit nga Burimi Vërmica

Përmbledhje

Qëllimi i këtij projekti është hartimi i projektit të detajuar për zgjerimin e furnizimit me ujë për qytetin e Prizrenit nga Burimi Vërmica. Projekti do të përfshijë hartimin e dokumentacionit në përputhje me legjislacionin, aktet rregullatore dhe standardet teknike për ndërtimin e objekteve hidroteknike.

Përmbajtja e Projektit:

- **Shpime gjeoteknike** për hartimin e projekteve të detajuara për objektet hidroteknike, duke përfshirë kaptazhën, stacionin e pompave, rezervuarët, etj.
- **Inçizimi gjeodezik dhe topografik** për lokacionet kryesore të projektit, përfshirë kaptazhën, stacionin e pompave dhe rezervuarët, si dhe trasenë ku duhet të kalojë gypi kryesor transportues i ujit.
- **Projektin për furnizimin me energji elektrike**, duke përfshirë transformatorët dhe pajisjet e tjera sipas fuqisë së angazhuar të energjisë për këtë projekt.
- **Projektin për ndërtimin e kaptazhës** për kapjen e ujit nga burimi Vërmica. Kapaciteti i kaptimit do të bazohet në matjet e prurjes në burim dhe lejen e shfrytëzimit të ujit të miratuar nga institucionet përkatëse.
- **Projektin për ndërtimin e rezervuarit grumbullues**, ku vëllimi i rezervuarit do të përcaktohet bazuar në sasinë e ujit të lejuar për kaptim nga burimi Vërmica.
- **Projektin për ndërtimin e rezervuarit kryesor furnizues për qytetin e Prizrenit**, ku pozicioni dhe lokacioni i tij do të përcaktohen duke marrë parasysh konfiguracionin e terrenit dhe synimin për një furnizim më të qëndrueshëm me ujë. Vëllimi i rezervuarit do të caktohet në bazë të nevojave ditore të konsumit të ujit në qytet dhe kapacitetit të ujit që pompohet.
- **Projektin për instalimin e gypave transportues** për lidhjen e kaptazhës, rezervuarëve dhe rrjetit shpërndarës.

Baza për Zhvillimin e Projektit: Përgatitja e projektit do të bëhet në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit dhe KRU Hidroregjioni Jugor, duke mbledhur dhe analizuar të dhënat relevante.

Shpimet Gjeoteknike: Shpimet janë të nevojshme për përcaktimin e kushteve gjeoteknike dhe dizajnimin e themeleve të objekteve. Këto shpime do të ndihmojnë për identifikimin e shtresave të tokës, kapacitetit mbajtës, dhe nivelit të ujërave nëntokësore. Përdorimi i shpimeve ndihmon gjithashtu për optimizimin e kostove dhe parandalimin e problemeve strukturore gjatë ndërtimit. Numri i shpimeve të bazohet nga madhësia e objektit dhe kushtet gjeoteknike.

Burimet e të Dhënave: Harta topografike, plane gjeodezike dhe kadastrale, të dhëna demografike dhe informacione të tjera relevante për zhvillimin e projektit.

A. Projekti për Furnizimin me Energji Elektrike

Qëllimi i këtij projekti është hartimi i zgjidhjes optimale për furnizimin dhe instalimin e infrastrukturës elektrike për objektet dhe pajisjet, duke përfshirë projektimin e një transformatori dhe lidhjen e tij me rrjetin ekzistues të tensionit të lartë, mesëm dhe të ulët.

Përshkrimi i Shërbimeve

Kompania e kontraktuar do të jetë përgjegjëse për hartimin e projektit për sistemin elektrik, duke përfshirë:

- **Projektimin e transformatorit** bazuar në fuqinë e pajisjeve elektrike të parashikuara në projekt, si pompimi, inverterët dhe pajisjet e tjera.
- **Hartimin e skemave elektrike** për lidhjen dhe shpërndarjen e energjisë në objektet kryesore.
- **Projektimin e rrjetit të kablove** për lidhjen e transformatorit me rrjetin e tensionit të lartë, mesëm dhe të ulët.
- **Përcaktimin e sistemeve të mbrojtjes dhe automatizimit** për të siguruar funksionim të sigurt dhe efikas të sistemit elektrik.

Dorëzimi i Shërbimeve dhe Dokumentacioni

Pas përfundimit të projektit, kompania duhet të dorëzojë:

- **Raportin teknik** për projektimin e sistemit elektrik.
- **Skemat dhe vizatimet përfundimtare** të instalimeve elektrike.
- **Specifikimet teknike të pajisjeve të projektuara.**
- **Dokumentacionin për standardet e zbatueshme** në projekt.

Kriteret Teknike dhe Standardizimi

Të gjitha zgjidhjet teknike dhe materialet duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare, duke garantuar një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike për të gjitha pajisjet e parashikuara në projekt.

B. Projekti për Ndërtimin e Kaptazhës së Burimit të Ujit Vërmicë

Vendndodhja dhe Kapaciteti

Kaptazha do të projektohet pranë burimit Vërmicë, duke siguruar një furnizim të qëndrueshëm me ujë në përputhje me kapacitetin e lejuar për shfrytëzim. Projekti synon të optimizojë marrjen e ujit pa ndikuar në ekosistemin natyror dhe në balancën hidrologjike të burimit.

Vlerësimi Hidrogeologjik dhe Gjeoteknik

Analiza hidrogeologjike përcakton prurjet e burimit dhe garanton që shfrytëzimi të bëhet në përputhje me kërkesat mjedisore. Studimi gjeoteknik vlerëson karakteristikat e tokës për të siguruar stabilitetin e strukturës dhe përshtatjen me kushtet ndërtimore.

Analiza e Faktorëve Rrezikues

Identifikohen faktorët që mund të ndikojnë në cilësinë dhe sigurinë e ujit, përfshirë burimet e ndotjes, rrezikun nga erozioni dhe ndikimet e aktiviteteve njerëzore. Strategjitë e mbrojtjes do të integrohen në projekt për të garantuar cilësi dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Projektimi i Kaptazhës

Struktura do të projektohet me materiale të qëndrueshme dhe rezistente ndaj lagështisë dhe ndikimeve mjedisore. Do të përfshijë një dhomë kontrolli për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të mbledhjes së ujit.

Sistemi i Mbledhjes së Ujit

Do të integrohen mekanizma për të siguruar rrjedhje të vazhdueshme dhe të pastër, duke parandaluar bllokimet dhe grumbullimin e ndotësve. Elementet e inspektimit do të mundësojnë monitorim dhe ndërhyrje të lehtë për mirëmbajtje.

Mbrojtja e Burimit

Zona përreth kaptazhës do të trajtohet sipas standardeve për mbrojtjen e burimeve ujore, duke përfshirë masat për shmangien e ndotjes nga aktivitetet bujqësore, industriale dhe urbane.

Lejet dhe Pëlqimet

Projekti do të zhvillohet në përputhje me rregulloret kombëtare dhe direktivat ndërkombëtare për menaxhimin e ujërave, duke siguruar të gjitha lejet e nevojshme mjedisore dhe ndërtimore.

Monitorimi dhe Kontrolli i Cilësisë

Do të përfshihen teste dhe monitorime të rregullta për cilësinë e ujit para dhe pas ndërtimit, me masa të përshtatshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin efikas të sistemit.

C. Projekti për Ndërtimin e Stacionit të Pompave me Rezervuar Ujëgrumbullues

Ky projekt përfshin projektimin e një stacioni pompash me rezervuar ujëgrumbullues për transportimin e ujit drejt rezervuarit kryesor, duke marrë parasysh sasinë e lejuar të ujit për pompim, lartësinë gjeodezike të rezervuarit dhe gjatësinë e linjës së transportit.

Projektimi i Stacionit të Pompave dhe Sistemit të Pompimit

Objekti do të projektohet për të siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe efikas të sistemit, duke përfshirë ndërtimin e strukturës kryesore dhe instalimin e pajisjeve teknike të përshtatshme për kërkesat hidraulike dhe operationale. Do të përdoren pajisje efikase energjetike për të optimizuar konsumin e energjisë dhe për të garantuar funksionim të qëndrueshëm.

Dimensionimi i Setit të Pompave

Për të garantuar transportin e ujit nga rezervuari ujëgrumbullues deri te rezervuari kryesor, do të dimensionohet një set pompash në bazë të sasisë së ujit të lejuar për pompim, humbjeve të ngarkesës hidraulike përgjatë linjës së transportit dhe lartësisë gjeodezike ndërmjet dy rezervuarëve.

- Numri dhe kapaciteti i pompave do të përcaktohen në mënyrë që të sigurohet rrjedha e nevojshme dhe presioni i duhur për transportin e ujit.
- Do të parashikohet një konfigurim me disa pompa aktive dhe një ose më shumë si rezervë për të siguruar vazhdimësi në operim.
- Pompat do të zgjedhen me karakteristika teknike që mundësojnë efikasitet të lartë, ulje të konsumit të energjisë dhe funksionim të sigurt në kushte të ndryshme të rrjedhës dhe presionit.

Sistemi i Transportimit të Ujit

Pompimi do të realizohet në përputhje me nevojat e rrjetit të furnizimit me ujë, duke siguruar një presion dhe rrjedhje të qëndrueshme. Linja e transportimit do të pajiset me elementë kontrolli dhe sigurie për të garantuar funksionim efikas dhe mbrojtje nga ndikimet hidraulike.

Pajisjet dhe Teknologjia e Kontrollit

Do të integrohen pajisje automatike për menaxhimin dhe monitorimin e procesit të pompimit, duke përfshirë sisteme të avancuara të kontrollit të frekuencës për rregullimin e shpejtësisë së motorëve. Sistemi do të jetë i pajisur me sensorë për monitorimin e presionit, niveleve të ujit dhe parametrave të funksionimit në kohë reale.

Efikasiteti dhe Automatizimi

Sistemi do të projektohet për të minimizuar humbjet dhe për të garantuar efikasitet maksimal në transportimin e ujit. Automatizimi i procesit do të mundësojë një operim të sigurt dhe të besueshëm, me mundësi të integritetit në sistemet qendrore të menaxhimit të ujit.

D. Projekti për Sistemin i Klorifikimit Automatik dhe Përpunimi i Ujit

Projekti duhet të sigurojë dezinfektimin e ujit dhe përmirësimin e cilësisë së tij përmes një procesi të kontrolluar dhe efikas. Për të garantuar siguri maksimale dhe përputhshmëri me standardet e cilësisë së ujit, do të integrohen teknologji të avancuara të dezinfektimit dhe monitorimit.

Sistemi i Dezinfektimit dhe Monitorimit

Do të zbatohet një proces i automatizuar për dozimin e klorit ose agjentëve të tjerë dezinfektues, duke garantuar trajtim të vazhdueshëm dhe efektiv të ujit gjatë transportimit. Sistemi do të jetë i pajisur me sensorë dhe monitorim të vazhdueshëm për të siguruar që përqendrimi i dezinfektuesit të mbetet brenda kufijve të rekomanduar.

Në rast se cilësia e burimit të ujit kërkon trajtim shtesë, do të integrohet një mekanizëm për rregullimin e parametrave fizikë dhe kimikë të ujit, siç është balancimi i pH-së për të parandaluar korrozionin dhe optimizuar efektin e dezinfektimit.

Alternativat për Dezinfektim

Në varësi të kushteve lokale dhe kërkesave të projektit, mund të përdoren metoda të ndryshme për dezinfektimin e ujit, duke përfshirë:

- **Dezinfektimi me klor të gaztë ose të lëngët**, duke siguruar mekanizma mbrojtës për operatorët dhe pajisje për neutralizimin e rrjedhjeve të mundshme.
- **Përdorimi i dioksidit të klorit ose metodave alternative**, të cilat mund të ofrojnë stabilitet më të lartë dhe reduktim të nënprodukteve të dezinfektimit.
- **Integrimi me sistemet e automatizuara të kontrollit**, të cilat lehtësojnë menaxhimin e dozimit dhe përshtatjen me ndryshimet në cilësinë e ujit në kohë reale.

Siguria dhe Menaxhimi i Emergjencave

Sistemi do të përfshijë masa mbrojtëse për operatorët, përfshirë pajisje të sigurisë dhe protokolle emergjente në rast të rrjedhjeve ose devijimeve nga parametrat e lejuar. Hapësirat e dezinfektimit do të pajisen me ventilim të kontrolluar dhe sinjalistikë për të garantuar një mjedis pune të sigurt.

Përshtatshmëria dhe Efikasiteti

Duke marrë parasysh nevojat specifike të projektit, kontraktori mund të propozojë zgjidhje më efikase dhe të përshtatshme për procesin e dezinfektimit, duke synuar minimizimin e ndikimit në mjedis, reduktimin e kostove operative dhe rritjen e sigurisë në menaxhimin e ujit të trajtuar.

E. Përgatitja e Projektit për Gypin Kryesor Transportues

Ky dokument përfshin hartimin e projektit të gypit kryesor transportues të ujit nga kaptazha deri te rezervuari ujëgrumbullues dhe më pas nga rezervuari ujëgrumbullues deri te rezervuari kryesor, duke përfshirë edhe degëzimet që lidhin rezervuarin kryesor me rrjetin ekzistues të ujësjellësit të Prizrenit. Gypi do të dimensionohet në përputhje me kapacitetin e burimit të ujit për të siguruar furnizim të qëndrueshëm, efikasitet hidraulik dhe konsum minimal të energjisë.

Objektivat e Projektit:

- Përcaktimi i diametrit optimal të gypit bazuar në prurjen maksimale të lejuar dhe parametrat hidraulikë.
- Zgjedhja e materialit dhe teknologjisë së ndërtimit për të garantuar jetëgjatësi dhe mirëmbajtje minimale.
- Përcaktimi i gjatësisë dhe profilin gjeodezik të linjës për të siguruar transport efikas të ujit.
- Projektimi i pajisjeve ndihmëse si valvulat, pusetat e ajrit dhe sistemet e monitorimit.
- Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret teknike dhe mjedisore për mbrojtjen e burimeve ujore dhe ekosistemit.

Tubacionet e parashikuara për këtë sistem do të përshtaten me konfiguracionin e terrenit të thyer ku do të kalojë gypi transportues, duke marrë parasysh kushtet gjeoteknike dhe klimatike. Për këtë arsye, materialet e përdorura duhet të ofrojnë qëndrueshmëri të lartë ndaj forcave të jashtme dhe të shmangin deformimet që mund të ndikojnë në funksionimin e sistemit.

Gypat nga materialet e forta si Giza e duktilizuar sigurojnë një avantazh shtesë, pasi e bëjnë të vështirë kyçjen e paautorizuar në rrjetin e ujësjellësit, duke ndihmuar në ruajtjen e integritetit të furnizimit me ujë dhe në parandalimin e humbjeve të ujit.

Diametrat e gypave do të dimensionohen në bazë të analizave hidraulike dhe prurjes maksimale të lejuar, duke siguruar që shpejtësia e rrjedhës të jetë brenda kufijve optimalë për të shmangur kavitacionin dhe humbjet e energjisë. Presioni operativ do të përcaktohet në mënyrë që të garantojë një furnizim të qëndrueshëm deri në rezervuarin kryesor dhe më tej në rrjetin e ujësjellësit.

Pajisjet ndihmëse, përfshirë valvulat e kontrollit, sistemet e ajrimit dhe shkarkimit, si dhe sensorët e monitorimit, do të integrohen për të garantuar funksionim efikas dhe mirëmbajtje të lehtë të sistemit. Të gjitha komponentët do të përputhen me standardet teknike për të siguruar jetëgjatësi dhe qëndrueshmëri në kushte të ndryshme operimi.

Në përfundim, ky projekt synon të sigurojë një sistem transporti të ujit të besueshëm dhe të qëndrueshëm, duke integruar teknologji bashkëkohore për monitorimin dhe menaxhimin e rrjedhës së ujit. Implementimi i tij do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e furnizimit me ujë për qytetarët dhe industrinë, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

F. Përgatitja e Projektit për Rezervuarin Kryesor

Hartimi i projektit kryesor për ndërtimin e një rezervuari të madh për furnizimin me ujë të qytetit të Prizrenit duhet të bëhet në përputhje me rregullat dhe standardet në fuqi. Ky rezervuar do të sigurojë një shpërndarje të qëndrueshme të ujit duke funksionuar me rrjedhje gravitacionale, duke eliminuar nevojën për pompim dhe reduktuar kostot e energjisë. Ai do të lidhet me **burimin** e Vërmicës dhe me sistemin e furnizimit të njësisë operative të Prizrenit, duke garantuar një furnizim të besueshëm me ujë për qytetin.

Dimensionimi i Rezervuarit Përcaktimi i kapacitetit të rezervuarit do të bëhet duke u bazuar në kërkesën ditore të ujit për qytetin dhe sasinë e ujit që pompohet drejt tij. Kapaciteti i tij do të sigurojë mbulimin e nevojave të konsumatorëve duke marrë parasysh variacionet në përdorim gjatë ditës dhe sezonit. Do të sigurohet gjithashtu një rezervë strategjike për raste emergjente ose ndërprerje të furnizimit.

Objektivat e Projektit

- Projektimi i një rezervuari të sigurt dhe efikas, duke marrë parasysh kërkesat hidraulike dhe strukturore.
- Sigurimi i ruajtjes së ujit me cilësi të lartë përmes materialeve dhe teknologjive të avancuara.
- Përcaktimi i lartësisë optimale të vendosjes për të garantuar shpërndarjen gravitacionale dhe presionin e duhur në rrjetin e furnizimit.
- Integrimi i pajisjeve ndihmëse për kontrollin dhe monitorimin e nivelit të ujit.
- Përputhshmëria me standardet teknike dhe mjedisore për të minimizuar ndikimet negative në ekosistem.

Karakteristikat Kryesore

- Struktura e rezervuarit do të jetë e ndërtuar me materiale të cilësisë së lartë, të përshtatshme për ruajtjen e ujit të pijshëm.
- Do të projektohet në një lartësi të favorshme për të siguruar shpërndarje efektive të ujit në rrjetin ekzistues.
- Do të sigurohet ventilimi dhe mbrojtja kundër ndotjes për të ruajtur higjienën dhe cilësinë e ujit.
- Pajisjet ndihmëse do të përfshijnë sisteme të monitorimit të nivelit të ujit dhe mekanizma mbrojtës për mbingarkesat hidraulike.

Monitorimi dhe Automatizimi Rezervuari do të pajiset me sisteme të avancuara të monitorimit, duke përfshirë sensorë për nivelin e ujit dhe sisteme telemetrie për mbikëqyrje në distancë. Do të integrohen alarme për situata emergjente për të siguruar funksionim të pandërprerë dhe ndërhyrje të shpejtë në rast nevojë.

Zbatimi i Projektit Për realizimin e këtij projekti, do të kryhen punime të ndryshme për të siguruar ndërtimin e rezervuarit sipas standardeve më të larta, duke përfshirë:

- Përgatitjen e terrenit dhe ndërtimin e infrastrukturës ndihmëse.
- Mijet dhe ndërtimin e strukturës kryesore.
- Instalimin e sistemit hidraulik dhe pajisjeve të nevojshme për funksionimin efikas.
- Vendosjen e sistemeve të monitorimit dhe automatizimit.
- Testimin dhe dezinfektimin përpara vënies në funksion.

Ky rezervuar duhet të përmirësojë ndjeshëm sistemin e furnizimit me ujë të qytetit, duke garantuar një furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm për të gjithë konsumatorët.

G. Përgatitja e Projektit për Sistemin SCADA

Për implementimin e një sistemi efikas të monitorimit dhe kontrollit të infrastrukturës së furnizimit me ujë, është e domosdoshme zhvillimi i një projekti të detajuar për sistemin SCADA (Supervisory Control and Data Acquisition). Ky sistem do të sigurojë mbikëqyrje të vazhdueshme, menaxhim të avancuar dhe optimizim të operacioneve për të garantuar shpërndarje të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë të ujit.

Qëllimi i Projektit Qëllimi kryesor i sistemit SCADA është krijimi i një platforme të integruar për monitorimin dhe kontrollin në kohë reale të rrjetit të furnizimit me ujë dhe rezervuarit. Sistemi do të mundësojë reagimin e shpejtë ndaj anomalive, rritjen e efikasitetit operacional dhe uljen e humbjeve të ujit.

Komponentët Kryesorë të Sistemit SCADA

1. **Njësitë e Mbledhjes së të Dhënave (RTU/PLC)**
 - Pajisjet për grumbullimin dhe transmetimin e të dhënave nga sensorët dhe valvulat.
 - Kontrolluesit logjikë të programueshëm (PLC) për menaxhimin e proceseve automatike.
2. **Sensorët dhe Pajisjet Matëse**
 - Sensorë të nivelit të ujit për monitorimin e rezervuarit.
 - Sensorë të presionit për të siguruar shpërndarje optimale.
 - Ujëmatës digjital për matjen e sasisë së ujit të konsumuar dhe të pompuar.
3. **Sistemi i Telekomunikimit**
 - Lidhje të sigurta të të dhënave përmes radio-frekuencave, fibra optike ose rrjetesh GSM.
 - Protokolle të enkriptuara për garantimin e sigurisë së të dhënave.
4. **Qendra e Kontrollit dhe Softueri SCADA**
 - Platformë e avancuar softuerike për vizualizimin dhe analizimin e të dhënave.
 - Panel komandimi për menaxhimin e alarmimeve dhe parametrave operativë.
5. **Automatizimi dhe Alarmet**

- Sisteme automatike për kontrollin e valvulave dhe pompave.
- Alarmime në kohë reale për humbje të presionit, rritje të turbullirës apo prani ndotjesh.

Përfitimet e Implementimit të SCADA

Menaxhim Efikas: Kontroll dhe optimizim i rrjedhës së ujit përmes analizave të vazhdueshme.

Ulje e Humbjeve: Identifikim i shpejtë i rrjedhjeve dhe ndërhyrje në kohë për riparime.

Kursim i Energjisë: Përdorim më racional i pompave dhe optimizim i konsumit të energjisë.

Siguri dhe Cilësi më e Lartë: Monitorim i parametrave të ujit për të garantuar sigurinë e furnizimit.

Konkluzioni Sistemi SCADA do të mundësojë një monitorim të avancuar të rrjetit të furnizimit me ujë dhe rezervuarit, duke garantuar menaxhim më të mirë, ndërhyrje të shpejta dhe reduktim të humbjeve. Përgatitja dhe implementimi i këtij projekti do të krijojë një sistem modern dhe të automatizuar, duke përmirësuar ndjeshëm shërbimin për qytetarët dhe optimizuar kostot operacionale.

ORARI I RAPORTIMIT

Raporti fillestar - 3 kopje fizike dhe 1 kopje elektronike - duhet të dorëzohet jo më vonë se një (1) muaj nga data e fillimit.

Dizajni konceptual i ndërmjetëm, pa raporte llogaritëse dhe të dhëna, i cili do të paraqesë paraqitjen përfundimtare të propozuar të skemës - 3 kopje fizike dhe 1 kopje elektronike - duhet të dorëzohet jo më vonë se një (3) muaj nga data e Fillimit. Prezantimi do t'i bëhet gjithashtu drejtpërdrejt në Komunën e Prizrenit.

Dizajni Kryesor Përfundimtar – 3 kopje të shtypura dhe 1 kopje vetëm elektronike dhe duhet të dorëzohet jo më vonë se shtatë (6) muaj nga data e fillimit të projektit.



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **144396**

Për **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Infra-Plus SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Hartimi i projektit detal për burimet e ujit të pijshëm nga burimi Vërmicës dhe Poslisht**

Nr. prokurimit: 622-25-2419-2-1-3 , Nr. brendshëm:

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **20,000.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **20,000.00€** siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 248 ditë kalendarike prej **01.10.2025** deri më **06.06.2026**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 01.10.2025

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

I nderuar klient !

Ju jemi mirënjohës që keni zgjedhur Kompaninë e sigurimeve "K.S. Elsig" për sigurimin e garancive për dëmet që mund t'u shkaktohen palëve kontraktuese nga veprimtaria e juaj e regjistruar me nr. të biznesit.

Deklarata e klientit

1. Personi që kanë nënshkruar këtë kërkesë është informuar nga siguroesi dhe është pajtuar, që:
- të dhënat personale të kësaj kërkesë, së bashku me të dhënat tjera, do të përpunohen dhe përdoren nga siguroesi, në lidhje me sigurimin e kontraktuar, për qëllime statistikore dhe për qëllime të hulumtimit (verifikimit)/raportimit në Regjistrin e Kreditor të Kosovës (RKK) si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.
- siguroesi do të ruaj të dhënat personale me sigurinë e nevojshme në regjistra, ku këto të dhëna do të strukturohen me ndihmën e kartelave apo përmes ndonjë baze elektronike të të dhënave si dhe do të raportohen në regjistrin e Kredive të Kosovës. - në këto të dhëna personale të përpunuara, personat e tretë nuk do të kenë qasje, përveç nëse është fjala për organet shtetërore kur kjo është e sanksionuar me ligj, si dhe për personat që përpunojnë të dhënat nën udhëheqjen e kompanisë K.S. "ELSIG" sh.a., apo kompanive partnere të KS "ELSIG" sh.a.
2. Personat që nënshkruajnë këtë policë, vërtetojnë se: vullnetarisht kanë dhënë informata personale për vetveten, si kusht i domosdoshëm për kontraktimin e këtij sigurimi, dhe se janë të pajtimit, që siguroesi të përpunojë ato të dhëna dhe t'u lejojë personave të tretë në pajtim me pikën 1 të këtij dokumenti, qasje në to.
3. Kontraktuesi i sigurimit vërteton me nënshkrimin e tij, se: është plotësisht i aftë dhe se nuk ka asnjë kufizim për hyrjen në marrëdhënie kontraktuese.
4. Personat që kanë nënshkruar këtë policë vërtetojnë se: në lidhje me këtë policë, nuk ka asnjë marrëveshje gojore shtesë.

Detyrimet e të siguruarit:

Të paguaj preminë e sigurimit kur e lidh kontratën e sigurimit : Të informojë siguroesin për rastin e siguruar afatit prej 3 ditësh: Të informojë siguroesin edhe atëherë kur kërkesa për dëmshpërblim kundër tij të jetë paraqitur nëpërmjet gjykatës, kur të jen nën arrest si dhe kur të ketë filluar procedura për sigurimin e provave: T'Idërgojë siguroesit dëshmitë e nevojshme për vlerësimin e shkaktarit dhe të natyrës së dëmit.

Detyrimet e siguroesit :

Pas ndodhjes të rastit të siguruar siguroesi është i detyruar: Të njoftojë të siguruarin me informacionet përkatëse lidhur me kushtet dhe tarifën e sigurimit të garancive : Të ndërmerre, bashkë me të

siguararin, mbrojtjen nga kërkesat e pa mbështetura ose të tepruara për kompensimin e dëmit: Të plotësoj kërkesat e bazuara për kompensimin e dëmit. Të përpunojë dhe të paguaj dëmin në afatin prej 15 ditësh pasi është bërë kompletimi i lëndës me dokumentacionin e nevojshëm. Pjesën përbërëse të kësaj police janë kushtet e sigurimit. Në rast kontesti lidhur me dëmin që ka ndodhur e që mbulohet me këtë policë, kompetente është gjykata e vendit ku është lidhur kontrata e sigurimit.

Dear Costumer!

We are very grateful that you have chosen I.C. "ELSIG" Insurance Company for Safeguards concerning the claims that can occurred to contractual party caused in the course of your registered business.

Costumer statements

1. Persons undersigned in this policy are informed and agreed, that: - personal data in this policy, and all other data, will be processed and used by insurer, related to contracted insurance, and for statistical purposes and for purposes of review (verification)/report in the Loan Register of Kosovo (RKK) and also for the transfer to the third party with the purpose of claim treatment.
- The insurer will keep all the personal data recorded with necessary safety in registers and all these data will be structured with the help of cards or through other electronic databases and also will be reported in the Loan Register of Kosovo. - in these processed personal data, third parties do not have approach, except the state authorities when this is sanctioned by law, as well as persons that process data under the leadership of the company I.C. "ELSIG" j.s.c., or partner companies of IC. "ELSIG" j.s.c.
2. Persons undersigned in this policy, certify that: voluntarily provided personal information about themselves, as necessary condition for the contraction of this insurance, and agreed that the insurer will process those data and will allow access in those to third parties in accordance with paragraph 1 of this document.
3. Insurance Contractor with his/her signature certifies that: is fully capable and that there is no restriction on entry in contractual relations.
4. Persons undersigned in this policy certify that: regarding this policy, there is no additional oral agreement.

Policyholder's obligations

To pay the insurance premium when he/she signs the insurance contract: To inform the insurer for the insured case within three days: To inform the insurer even when the claim for the compensation is submitted through the court, when under arrest as well as when the procedure for evidence collection has begun: To submit to the insurer necessary evidence for the claim evaluation and its nature and cause.

Insurer's obligations

After the claim has occurred for an insurable event, the insurers obliged to: To inform the insured with appropriate information concerning the terms, conditions and the tariffs for Safeguards insurance. Together with the insured needs undertake the necessary measures in order to prevent unnecessary and/or excessive claims for compensation: To meet the requirements needed to compensate the claim: The insurer needs to review and compensate the claim no later 15 days after the file has been completed with the necessary information: Integral part of this policy are the insurance terms and conditions mentioned above. In the case of the contest related to the loss or damage covered with this policy, competent court is the court in the territory where the insurance contract is signed.

Paraqitja e dëmeve / Claim Handling Office

Drejtoria & Filiali në Prishtinë / Branch rruga :
Tringë Ismajli nr. 3
Tel.038 / 221 - 114: fax 038 / 221 - 115
e - mail : office@kselsig.com

Filiali / Branch :

Mitrovicë Tel.044 / 381 - 790	Pejë Tel.049 / 810 - 847
Ferizaj Tel.044 / 655 - 678	Prizren Tel.044 / 174 - 098
Gjakovë Tel.044 / 760 226	Gjilan Tel. 044 / 212 -378



ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni



Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a , Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,
Tel: +383 (0) 38 221 112: Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **144396**

Kontraktuesi

Emri	Infra-Plus SH.P.K.
Përfaqësuar nga	Musa Islamaj
Adresa	Rruga Prishtinë-Ferizaj, Km 5, pn, Graçanicë,, Prishtinë
Nr i Biznesit	810175225
Telefoni	038606262

Përfituesi

Emri	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
Adresa	PRIZREN

Garantuesi

Emri	Elsig
Banka Garantuesit	NLB

Mbulueshmëria e Polices

Shuma Siguruar	20,000.00
Periudha Sigurimit	01.10.2025 - 06.06.2026
Primi	360.00
Tvsh	64.80
Primi Bruto	424.80
Data e lëshimit	01.10.2025 11:01

Aktiviteti Ekonomik:

Hartimi i projektit detal për burimet e ujit të pijshëm nga burimi Vërmicës dhe Poslisht

Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
- Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
ASK-Broker - 4472



Përfaqësuesi i të siguarit
Musa Islamaj

I nderuar klient !

Ju jemi mirënjohës që keni zgjedhur Kompaninë e sigurimeve "K.S. Elsig" për sigurimin e garancive për dëmet që mund t'u shkaktohen palëve kontraktuese nga veprimtaria e juaj e regjistruar me nr. të biznesit.

Deklarata e klientit

1. Personi që kanë nënshkruar këtë kërkesë është informuar nga siguroesi dhe është pajtuar, që:
- të dhënat personale të kësaj kërkesë, së bashku me të dhënat tjera, do të përpunohen dhe përdoren nga siguroesi, në lidhje me sigurimin e kontraktuar, për qëllime statistikore dhe për qëllime të hulumtimit (verifikimit)/raportimit në Regjistrin e Kreditor të Kosovës (RKK) si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.
- siguroesi do të ruaj të dhënat personale me sigurinë e nevojshme në regjistra, ku këto të dhëna do të strukturohen me ndihmën e kartelave apo përmes ndonjë baze elektronike të të dhënave si dhe do të raportohen në regjistrin e Kredive të Kosovës. - në këto të dhëna personale të përpunuara, personat e tretë nuk do të kenë qasje, përveç nëse është fjala për organet shtetërore kur kjo është e sanksionuar me ligj, si dhe për personat që përpunojnë të dhënat nën udhëheqjen e kompanisë K.S. "ELSIG" sh.a., apo kompanive partnere të KS "ELSIG" sh.a.
2. Personat që nënshkruajnë këtë policë, vërtetojnë se: vullnetarisht kanë dhënë informata personale për vetveten, si kusht i domosdoshëm për kontraktimin e këtij sigurimi, dhe se janë të pajtimit, që siguroesi të përpunojë ato të dhëna dhe t'u lejojë personave të tretë në pajtim me pikën 1 të këtij dokumenti, qasje në to.
3. Kontraktuesi i sigurimit vërteton me nënshkrimin e tij, se: është plotësisht i aftë dhe se nuk ka asnjë kufizim për hyrjen në marrëdhënie kontraktuese.
4. Personat që kanë nënshkruar këtë policë vërtetojnë se: në lidhje me këtë policë, nuk ka asnjë marrëveshje gojore shtesë.

Detyrimet e të siguruarit:

Të paguaj preminë e sigurimit kur e lidh kontratën e sigurimit : Të informojë siguroesin për rastin e siguruar afatit prej 3 ditësh: Të informojë siguroesin edhe atëherë kur kërkesa për dëmshpërblim kundër tij të jetë paraqitur nëpërmjet gjykatës, kur të jen nën arrest si dhe kur të ketë filluar procedura për sigurimin e provave: T'Idërgojë siguroesit dëshmitë e nevojshme për vlerësimin e shkaktarit dhe të natyrës së dëmit.

Detyrimet e siguroesit :

Pas ndodhjes të rastit të siguruar siguroesi është i detyruar: Të njoftojë të siguruarin me informacionet përkatëse lidhur me kushtet dhe tarifën e sigurimit të garancive : Të ndërmerre, bashkë me të

siguruarin, mbrojtjen nga kërkesat e pa mbështetura ose të tepruara për kompensimin e dëmit: Të plotësoj kërkesat e bazuara për kompensimin e dëmit. Të përpunojë dhe të paguaj dëmin në afatin prej 15 ditësh pasi është bërë kompletimi i lëndës me dokumentacionin e nevojshëm. Pjesën përbërëse të kësaj police janë kushtet e sigurimit. Në rast kontesti lidhur me dëmin që ka ndodhur e që mbulohet me këtë policë, kompetente është gjykata e vendit ku është lidhur kontrata e sigurimit.

Dear Costumer!

We are very grateful that you have chosen I.C. "ELSIG" Insurance Company for Safeguards concerning the claims that can occurred to contractual party caused in the course of your registered business.

Costumer statements

1. Persons undersigned in this policy are informed and agreed, that: - personal data in this policy, and all other data, will be processed and used by insurer, related to contracted insurance, and for statistical purposes and for purposes of review (verification)/report in the Loan Register of Kosovo (RKK) and also for the transfer to the third party with the purpose of claim treatment
- The insurer will keep all the personal data recorded with necessary safety in registers and all these data will be structured with the help of cards or through other electronic databases and also will be reported in the Loan Register of Kosovo. - in these processed personal data, third parties do not have approach, except the state authorities when this is sanctioned by law, as well as persons that process data under the leadership of the company I.C. "ELSIG" j.s.c., or partner companies of IC. "ELSIG" j.s.c.
2. Persons undersigned in this policy, certify that: voluntarily provided personal information about themselves, as necessary condition for the contraction of this insurance, and agreed that the insurer will process those data and will allow access in those to third parties in accordance with paragraph 1 of this document.
3. Insurance Contractor with his/her signature certifies that: is fully capable and that there is no restriction on entry in contractual relations.
4. Persons undersigned in this policy certify that: regarding this policy, there is no additional oral agreement.

Policyholder's obligations

To pay the insurance premium when he/she signs the insurance contract: To inform the insurer for the insured case within three days: To inform the insurer even when the claim for the compensation is submitted through the court, when under arrest as well as when the procedure for evidence collection has begun: To submit to the insurer necessary evidence for the claim evaluation and its nature and cause.

Insurer's obligations

After the claim has occurred for an insurable event, the insurers obliged to: To inform the insured with appropriate information concerning the terms, conditions and the tariffs for Safeguards insurance. Together with the insured needs undertake the necessary measures in order to prevent unnecessary and/or excessive claims for compensation: To meet the requirements needed to compensate the claim: The insurer needs to review and compensate the claim no later 15 days after the file has been completed with the necessary information: Integral part of this policy are the insurance terms and conditions mentioned above. In the case of the contest related to the loss or damage covered with this policy, competent court is the court in the territory where the insurance contract is signed.

Paraqitja e dëmeve / Claim Handling Office

Drejtoria & Filiali në Prishtinë / Branch rruga :
Tringë Ismajli nr. 3
Tel.038 / 221 - 114: fax 038 / 221 - 115
e - mail : office@kselsig.com

Filiali / Branch :

Mitrovicë Tel.044 / 381 - 790	Pejë Tel.049 / 810 - 847
Ferizaj Tel.044 / 655 - 678	Prizren Tel.044 / 174 - 098
Gjakovë Tel.044 / 760 226	Gjilan Tel. 044 / 212 -378